

BEQIR META**ÇËSHTJA E PAKICAVE GJATË CAKTIMIT TË KUFIRIT
JUGOR TË SHQIPËRISË NË VITIN 1913**

Problemi i caktimit të kufijve politikë të shtetit shqiptar deri më sot është trajtuar gjerësisht nga studiuesit shqiptarë. Në këtë artikull, duke u bazuar në burime autentike arkivore do të trajtojmë diskutimin e çështjes së pakicave në procesin e përcaktimit të kufirit jugor të Shqipërisë nga Konferenca e Ambasadorëve në Londër në vitin 1913 dhe më tej prej Komisionit që u caktua nga Konferenca për përcaktimin në terren të kufijve jugor të Shqipërisë.

Në procesin e caktimit të kufijve politikë të Shqipërisë pati diskutime se cila do të ishte shtrirja e tyre dhe çfarë popullsie do të përfshihej në shtetin e ri. Patriotët shqiptarë kërkonin një shtet kombëtar, i cili të përfshinte territoret ku shqiptarët banonin në shumicë duke pranuar një standard relativisht të lartë për trajtimin e minoriteteve të huaja që eventualisht do të mbeteshin brenda këtij shteti si rezultat i kushtëzimeve gjeografike në caktimin e kufirit. Këtë qëndrim mbanin edhe shumë miq të Shqipërisë në Perëndim të cilët kërkonin që kufijtë e shtetit të ri të vendoseshin me korrektësi, duke respektuar kriterin etnik. Një përcaktim interesant në këtë drejtim bënte edhe Komiteti Proshqiptar i Londrës i kryesuar nga Aubrey Herbert. Ky komitet hartoi një dokument themelor politik të titulluar “The Plea of Albania” në të cilin shkruante se numri i shqiptarëve që pretendohen të futen në shtetin autonom të Shqipërisë është 2.2 milion banorë. Shqiptarët formojnë shumicën në të gjitha rajonet e këtij territori dhe jetojnë në masë kompakte. Brenda këtij territori përfshihen këto popullsi joshqiptare: grekët në jug rreth 30.000; 100.000 serbë dhe 120.000 bullgarë, në rajonet e Kosovës, Shkupit dhe Manastirit. Në kufijtë e shtetit shqiptar që do të përmbliidhte katër vilajetet pra 2.2 milion banorë, ata theksonin se do të futej një popullsi vllahe prej 200.000 banorësh.¹ Por Fuqitë nuk ndoqën kriterin etnik në

¹ *British National Archives, London, Public Record Office; Foreign Office (më tej: FO) 371/1778, Komiteti shqiptar, Londër 1912-1913, me kryetar Aubrey Herbert, Anëtarë: Mr. C.F. Abbott; Elise Aubrey; Dr. Thos Baty, S.L. Bensusan;*

përcaktimin e kufijve dhe gjymtuan territoret shqiptare. Si rezultat numri i pakicave brenda kufijve të tij do të ishte shumë i vogël. Gjithsesi edhe problemi i këtyre pakicave pati një vend në diskutimet që u bënë për vendosjen e kufijve.

Fuqitë e Mëdha dhe Komisioni Ndërkombëtar për caktimin e kufijve të shtetit të ri shqiptar, gjatë procesit të caktimit të kufijve u ndeshën edhe me problemin e pakicave. Edhe në këtë çështje përfaqësuesit e të dy blloqeve kishin diferenca të theksuara pikëpamjesh. Austro-Hungaria dhe Italia mbështetën përfshirjen e sa më shumë territoreve të banuara nga vllehtë në shtetin e ri shqiptar. Gjithashtu ata e panë si primare çështjen e mbrojtjes dhe funksionit strategjik dhe ekonomik të shtetit shqiptar dhe në këtë këndvështrim vlerësuan edhe përfshirjen e minoritetit të vogël grek në këtë shtet.

Çështja e pakicave u trajtua fillimisht gjatë diskutimeve në Konferencën e Londrës. Një vend të posaçëm pati edhe trajtimi i çështjes së vllëve.

Me fillimin e Luftërave Ballkanike, Rumania u përpoq ta shfrytëzonte çështjen vllëve për interesat e saj politike. Vlen të përmendet në këtë drejtim një artikull i botuar në gazetën, “Pester Lloyd”, më 7 dhjetor 1912.² Artikulli ishte porositur nga një diplomat rumun, i cili i kishte dhënë gazetës dhe mjaft të dhëna. Në të pohohej se persekutimi i vllëve nga shtetet nacionaliste ballkanike kishte ndikuar që Rumania gjatë Luftërave të fundit Ballkanike të mos kishte besim tek aleatët ballkanas. Në këto rrethana, opinionioni publik dhe diplomacia rumune këmbëngulnin që e gjithë Maqedonia dhe Shqipëria duheshin shpallur provinca autonome. Ndërsa influenza greke dhe serbe duhej zhdukur prej andej. Në këtë artikull paraqiteshin këto argumente, të cilat ishin dhe të diplomacisë rumune:

- Ndarja e Maqedonisë tashmë ishte më e vështirë për t’u realizuar. Bullgarët ia kishin lënë Shkupin serbëve, por gjithkush e dinte se vendi ishte më së shumti qytet bullgaro-vllëh dhe grekët po zhdukeshin me shpejtësi prej këtij qyteti. Nga 37.500 banorë, 10.000 ishin sllavë, 10.500

O.Brilliant; L. Cranmer Byng, Josie Dowling; Rev. M. Gaster; D. D.; Dr. M. A. Hafiz; Hon-Mrs Aubrey Herbert; Miss Sybial Judge; Mark H. Judge, Lord Lamington, Dr. A.Majid, Duse Mohammed, F. S.Noli, J.C. Paget; Marmaduke Pickthall; Charles Rosher; C.F. Ryder.

² FO 371/1517, ekstrakt nga “Pester Lloyd”, 7 dhjetor 1912 me titull: “Problemi maqedon dhe interesat rumune”.

grekë, 7.000 vllleh, 5.000 hebrenj dhe vetëm 50 veta ishin grekë. Por pavarësisht nga ky fakt, grekët shpresonin të merrnin Manastirin kur të ndahej Maqedonia. Për t'u vënë në dukje është se këtu nuk përmendej fare ekzistenca e popullsisë shqiptare në këtë qytet.

- Evidentohej shqetësimi i madh për të ardhmen e popullsisë vllahe se çfarë do të bëhej me të në Maqedoni. Theksohej se një pjesë e saj fatmirësisht do të bëhej pjesë e shtetit të lirë shqiptar, i cili do të ndërtohej dhe në këtë rast, të paktën arumunët, të cilët ishin në marrëdhënie të mira me shqiptarët do të kishin mundësi të zhvilloheshin. Por numri më i madh i arumunëve jetonte në Maqedoni dhe Epir. Çfarë fati i priste ata dhe çfarë garancish u ofroheshin atyre që jo vetëm të mbroheshin nga persekutimi, por që të lejoheshin të bënin progres nën kujdesin atëror të Rumanisë?

- Kjo cilësohej një nga pikat delikate të çështjes maqedone dhe Aleanca Ballkanike nuk duhej ta komplikonte atë nëpërmjet persekutimit të padrejtë të vllëve, pasi kjo do të krijonte një ndjenjë armiqësore, madje të rrezikshme në Rumani.

Në këtë artikull nënvizohej se shtetet ballkanike po zgjeroheshin, në të vërtetë jo si rezultat i fitoreve të ushtrive të tyre, por si rezultat i atyre kombeve, të cilët e kishin bërë të mundur këtë sukses. Në qoftë se Evropa do njëjtte të drejtën e Rumanisë për kompensim moral dhe material, atëherë Aleanca Ballkanike nuk duhej të humbiste kohë për t'i shprehur Rumanisë mirënjohjen e saj. "Ata nuk duhet t'i lejojnë vetes të helmohen prej sukseseve të tyre, saqë të mohojnë ekzistencën e të tjerëve ose të nënvlerësojnë të tjerët. Ata nuk duhet të harrojnë që çështja e balancës së forcave të fuqishme në Ballkan – sipas fjalimit të markezit Bacquehem, do të vendoset jo vetëm në kufirin e Dubnuçës, por në zemër të Maqedonisë. Së fundi, ata nuk duhet të harrojnë se në marrjen e vendimit për këto çështje duhen konsideruar edhe faktorë të tjerë përveç ushtrive të tyre. Ato janë: drejtësia, mbështetja unanime e fuqive dhe forca e padiskutueshme e Monarkisë Rumune".³

Vendosmërinë e qeverisë rumune për të zgjidhur në mënyrë të favorshme çështjen e vllëve e vuri në dukje edhe ministri i Jashtëm austro-hungarez. Ky i tha ambasadorit britanik, Ser F. Cartwright se kishte pasur një takim me ministrin rumun në Londër dhe kishte kuptuar prej tij se Rumania i jepte rëndësi më të madhe përfshirjes së territoreve

³ Po aty.

të banuara nga vllehtë në Shqipëri. Rumania do të kundërshtonte me forcë vendosjen e kësaj popullsie nën sundimin grek. Ministri i Jashtëm austro-hungarez mendonte se përfaqësuesi rumun duhej të pranohej në Konferencën e Ambasadorëve për të paraqitur pikëpamjet e tij për këtë çështje.⁴

Edhe britanikët nuk ishin kundër thirrjes së përfaqësuesit rumun në Konferencë megjithëse Rumania kishte qenë pjesëmarrëse në Luftën Ballkanike. Qysh në mars të vitit 1913, Edward Grey (Eduard Grei) i tha ministrit rumun se, meqë po afrohej diskutimi i çështjes së kufijve jugorë të Shqipërisë, ai së bashku me Ambasadorët do të ishin të kënaqur nëse ky merrte pjesë në takimin e 25 marsit të Konferencës për të dhënë informacionet dhe pikëpamjet e qeverisë rumune në lidhje me vendbanimet e vllahëve.⁵ Ndërkohë Grey kishte arritur në përfundimin që Mecova do t'i lihej Greqisë, jo sepse Greqia e kishte pushtuar atë, por sepse hetimet kishin provuar se atje ekzistonte një shumicë greke. Ai mendonte se një pjesë e kucovllahëve duhej të përfshiheshin në Shqipëri, dhe kur të fillonte zgjidhja e kësaj çështjeje, ministri rumun do të ftohej në Konferencën e Ambasadorëve për të shprehur pikëpamjet e tij.⁶

Qeveria rumune përfitoi nga thirrja e saj në Konferencën e Ambasadorëve dhe paraqiti atje pikëpamjet e saj për çështjen vllahë. Ajo deklaroi se e shikonte me kënaqësi krijimin e një shteti shqiptar të pavarur. Në këtë shtet do të ruhej individualiteti i rumunëve. Për këtë qëllim kufijtë e Shqipërisë duhej të përcaktoheshin në mënyrë që, jo vetëm ky shtet të mos kishte vështirësi më vonë me fqinjët, por që edhe popullsia rumune, e cila ishte më kompakte në juglindje të Shqipërisë, të ruhej e paprekur në kufijtë e shtetit shqiptar.⁷

Në memorandumun e qeverisë rumune thuhej se rajoni mes qyteteve të Janinës, Mecovës, Grebenesë dhe malit Gramoz, banohej prej një popullsie, në pjesën më të madhe, rumune, e cila mund të vlerësohej se arrinte në më shumë se 80.000 banorë. Kjo popullsi ishte grupuar në 36 fshatra. Më kryesorët prej tyre ishin: Samarina, Avdele, Perivoli, Kranja, Labanica, Saracu, Porovala, Laista, Leshnica, Breaza, Turja, Mexhidie etj. Qeveria rumune theksonte se dy anët e Pindit që nga Mali Gramoz

⁴ FO 371/1757, Sër F. Cartwright për Sër E. Grey, Vienë 3 janar 1913.

⁵ FO 371/1801, E. Grey për Sër G. Barclay, FO 20 mars 1913.

⁶ FO 371/1801, E. Grey për R. Rodd. FO 17 mars 1913.

⁷ FO 371/1801, Legata e Rumanisë në Londër – Memorandum për E. Grey, 27 mars 1913.

deri në Agrafa ishin të zëna në pjesën më të madhe prej rumunëve. Një pjesë e kësaj popullsie ishte aneksuar në Greqi pas Traktatit të Berlinit. Rumunët kishin protestuar atëherë kundër këtij aneksimi. Do të ishte e padrejtë të lejohej përsëri një ndarje e trungut kompakt të arumunëve dhe të aneksohej përsëri në shtetet e tjera, përveç Shqipërisë.

Rumania mendonte se individualiteti nacional i vllahve do të ruhej më mirë në një shtet shqiptar të pavarur, nën garancinë e Fuqive të Mëdha.⁸ Kufijtë e këtij shteti duhet të fiksoheshin në mënyrë sa më pak të diskutueshme për të evituar shqetësimet e ardhshme në këto zona. Qeveria rumune konsideronte si kufijtë më të mirë natyrorë për Shqipërinë Juglindore malet e Zagorisë (Miçikeli dhe Papingo), lugina e lumit Inahos derisa bashkohet me lumin Aota (Arachtos) deri në burimin e këtij lumi në Jug (Zygos). Nga këtu kufiri të kalonte në Mecovo, duke ndjekur kufirin e atëhershëm të Greqisë deri në lumin Venetiko dhe nga aty derisa bashkohet me Bistricën (Aliacmon-Indja Sou). Pastaj të ndiqte rrjedhën e Bistricës deri në Darda, Gramoste, Korçë deri në liqenin e Prespës. Në memorandumun e qeverisë rumune thuhej se popullata e këtyre zonave ishte në pjesën më të madhe rumune, myslimanë rumunë (muhamedan rumun të quajtur vllahidi), shqiptarë dhe pak minoritet grek.

Për ruajtjen e individualitetit kombëtar të rumunëve të këtyre zonave që do përfshiheshin në Shqipëri, qeveria rumune kërkonte që Fuqitë e Mëdha, të nënshkruanin jo vetëm traktatin ndërkombëtar që do të zëvendësonte Traktatin e Berlinit, por edhe Kushtetutën ose Statutin Organik të Shqipërisë. Në këtë statut duhej të futej parimi që në zonat kompakte rumune, gjuha administrative të ishte rumanishtja, ashtu si dhe në gjithë kishat e shkollat rumune. Shteti i ri shqiptar duhej t'u garantonte një autonomi administrative dhe komunale dhe, sa më shumë të ishte e mundur, edhe një autonomi politike rumunëve të shumtë të Shqipërisë, duke mos i krijuar asnjë vështirësi funksionimit të kreut fetar rumun të kantoneve të banuara prej rumunëve. Shteti rumun duhej të kishte të drejtë që, ashtu si në të shkuarën, të subvenciononte institucionet e kulturës rumune në Shqipëri, pa pasur asnjë pengesë nga ana e shtetit shqiptar.⁹

Pasi u njoh me kërkesat e lartpërmendura të qeverisë rumune Foreign Office (Forin Ofis) bëri këto vërejtje: Nga ana etnografike

⁸ Po aty.

⁹ Po aty.

propozimi i ministrit rumun, Misu u cilësua si mjaft korrekt, por ishte e natyrshme që, pothuajse, gjithë vllhtë do të përfshiheshin në Greqi. Vija e kufirit e propozuar nga Misu kishte shumë pak shanse për tu pranuar.¹⁰ Një zyrtar tjetër i lartë i Foreign Office shtonte se “grekëve duhet t’u kërkohet që të japin garancitë që kërkon z. Misu”.¹¹

Ndërkohë qeverisë britanike i erdhi një dokument i qeverisë austro-hungareze, i cili i paraqiste si më poshtë fshatrat e banuara nga vllhtë:¹²

Rajoni i Pindit që konsiderohej si qendra e vllëve përbëhej nga këto fshatra:

A. Nga Zagoria në Janinë, drejt malësisë

BAEASSA (VOVUSSA-VJOSA)	940 banorë
TSSHERNECHI	1.700 “
MAKRINI	860 “
DRAGARI	660 “
CHECHOU	330 “
FLORON (FLAMBOURAROU)	1.300 “
GREBENITZI	3.000 “
METZOVA	8.000 “
ANILIO	3.000 “
SERACOU	<u>8.000 “</u>
	27.790 banorë

B. Drejt Lindjes

AMEROU (MILIA)	820 banorë
PALTENI (BALTINON)	250 “
BOSOVA	150 “
VELONA (BOBLONA)	50 “
ORAGNEA (TURIA)	3.500 “
LABANITZA	180 “
PIRVOLI	6.000 “
ABELA (AVDELA)	4.500 “
SMIKSI	1.500 “
SAMARINA	<u>10.000 “</u>
	26.950 banorë

¹⁰ FO 371/1801, Shënime të FO për memorandumun rumun, 28 mars 1913.

¹¹ Po aty.

¹² FO 371/1801, Dokument i kontit Mensdorff (Mensdorf) drejtuar qeverisë britanike mbi territoret vllëve, 8 prill 1913.

C. Drejt luginës së Vjosës

LAISTA	5.900 banorë
POLIOHORI	650 “
DOBRINOVA	1.450 “
LECHNITZA	2.500 “
BREAZA	1.580 “
ARMATA	260 “
PADZI	1.450 “
PALIOSSELI	2.200 “
FOURCA	<u>2.000</u> “
	17.990 banorë

D. Në malin Gramoz

DENISCOU	1.000 banorë
PALICADI	230 “
MEDJIDIE	2.500 “
GRAMOSTE	<u>500</u> “
	4.230 banorë
TOTALI	76.960 banorë

Dokumenti austro-hungarez përcaktonte se nëse Korça do t'i jepej Shqipërisë, siç ishte edhe propozimi rumun, atëherë në këtë anë të kufirit do të mbeteshin kjo popullsi dhe këto institucione vllahe:

	Shkolla vllahe	Mësues	Nxënës	Pop. vllahe
Korça	2	5	137	1.200
Pleassa	2	4	129	500
Moscopole	2	3	51	2.500
Chipska	1	2	49	250
Bitcouki	1	2	24	200
Nicea	1	1	27	1.500
Lanca	1	2	47	1.000

Përveç këtyre fshatrave vllahe dokumenti i lartpërmendur shtonte se popullsi e shpërndarë vllahe ekzistonte edhe në këto lokalitete:

DISHNICA	200 banorë vllah
STROPANI	180 “
BOULOUCHTITZA	80 “
GRABOVA	350 “
POGRADECI	140 “
GRAMOSTE	500 “

Përveç Rumanisë edhe popullsia vllahe ishte aktivizuar për të shfaqur dëshirën e saj për bashkimin me shtetin e ri shqiptar. Faktin që popullsia e Pindit mbështeste bashkimin me Shqipërinë e ka pohuar edhe një njohës i mirë i trevës dhe i politikave të kohës si Sejfi Vllamasi. Ai shkruante se krerët e kësaj popullsie që dimëronin bagëtinë në Konispol e Delvinë, zgjodhën një komision, i cili shkoi në Vlorë dhe i deklaroi I.Qemalit se populli i Pindit kishte vendosur ta lidhte fatin e vet me Shqipërinë dhe për realizimin e këtij qëllimi ishin gati të luftonin kundër Greqisë, bashkë me shqiptarët. I.Qemali e pranoi në parim kërkesën e tyre, por Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit, i njoftuar prej Fejzi Alizotit, u revoltua kundrejt qëndrimit të tij. Madje, Sejfi Vllamasi pohon se implikimi i I.Qemalit në marrëveshjen që bëri me popullin e Pindit për të modifikuar kufirin e Jugut që kishte caktuar Konferenca e Ambasadorëve ishte njëri ndër shkaqet që çoi në dorëheqjen e tij, e cila ishte e këshilluar nga KNK.¹³

Në momentet e caktimit të kufirit jugor në Konferencën e Ambasadorëve (mars-gusht 1913) po zhvillonte aktivitetin e tij edhe Beqir Grebeneja, i cili përpiqej të angazhonte Shqipërinë në një aleancë bullgaro-turke kundër Serbisë e Greqisë. Në maj të vitit 1913, ai qëndroi në Bukuresht ku, me ndërmjetësinë e shqiptarëve të atjeshëm, vendosi kontakte me qarqet politike rumune. Në këtë kohë qeveria rumune ishte angazhuar që krahinat e kucovllahëve të Pindit të bashkoheshin me Shqipërinë e pavarur, si një rajon administrativ autonom i veçantë. Qeveria rumune ishte gati të bënte sakrifica, me qëllim që, me ndihmën e çetave kucovllahe, shqiptare dhe bullgare të arrihej ky objektivi. Por më vonë marrëdhëniet e Rumanisë me Bullgarinë u keqësuan. Në shtator, I. Qemali, i cili e kishte pritur me shumë simpati projektin e lartpërmendur të inkorporimit në Shqipëri të kucovllahëve të Pindit, kërkoi në mënyrë të veçantë dhe të fshehtë vetëm prej Vjenës këshilla se çfarë duhej të bënte me projektin e lartpërmendur.¹⁴

Berchtold-i (Berchtold) dha këshilla të prera që, në mënyrë konfidenciale, t'i thuhej I. Qemalit se për çështjet që kishin të bënin me kufirin jugor të Shqipërisë, pra edhe për krahinën e vllahëve të Pindit,

¹³ Sejfi Vllamasi, *Ballafaqime politike në Shqipëri, 1897-1942*, Tiranë: "Marin Barleti", 1995, f.50, 52.

¹⁴ *Haus und Hof Staats Archiv, Wien, Politisches Archiv, Albanien* (më tej: *HHSSt.A.PA.A.*) viti 1913, dos. 23-10, fl. 1001-1100, Lejhanec për kontin Berchtold, Vlorë, 14 korrik 1913.

shqiptarët duhej të vepronin ashtu siç kishin bërë deri në këtë kohë, duke influencuar opinionin publik evropian me anë mitingjesh dhe rezolutash. Vjena theksonte se kishte një dyshim të madh për ndërmarrjen e një aksioni me anë të bandave dhe këtë dyshim e përforconte më tepër gjendja aktuale e luftës.¹⁵

Gjatë pranverës së vitit 1913 qeveria rumune po bënte të gjitha përpjekjet që vllëhtë të përfshiheshin në shtetin shqiptar. Ajo kërkoi edhe mbështetjen e qeverisë italiane, e cila në këtë kohë ishte violina e parë brenda Trepalëshit, sa i përket çështjes së kufirit jugor. Vizita e princit Carol (Karol) të Rumanisë u zhvillua me entuziazëm e miqësi të madhe në Itali. Kështu Ministri britanik në Romë i shkruante E. Grey-t se “unë nuk isha i habitur kur dëgjova nga i ngarkuari me Punë i Greqisë se Ministri i jashtëm italian i kishte thënë që, për arsye të marrëdhënieve shumë të përzemërta midis Italisë e Rumanisë, është e pamundur që Italia të injorjë dëshirën e fortë të shprehur nga qeveria rumune që kucovllahët e Pindit duhet të përfshihen në Shqipëri e jo në Greqi.”¹⁶ Këtë propozim i ngarkuari me Punë i Greqisë e përshkroi si krijimin e një enklave shqiptare në zemër të Greqisë.¹⁷

Gjithashtu në diskutimet që kishte pasur ministri britanik në Romë, Rodd me markezën di San Giuliano, vazhdimisht i kishte thënë se Austro-Hungaria kishte qenë gjithmonë e prirur të kryesonte mbrojtjen e interesave rumune. Në takimin e 25 majit S. Giuliano i foli Rodd për rritjen graduale të ndjenjave kombëtare midis grupeve të veçanta të vllëhve 30-40 vitet e fundit, të cilët para se të zhvillohej një propagandë aktive nga një komitet i krijuar në Manastir, nuk kishin bërë kundërshtime ndaj helenizimit të tyre. Ata tani po e kundërshtonin helenizimin dhe ky ishte një fakt që duhej marrë parasysh. Rodd, i tha me këtë rast S. Giulianos, se nuk kishte pak vllëh edhe në Hungari dhe e pyeti nëse Austria ishte po kaq e shqetësuar për asimilimin e tyre prej hungarezëve.

Rodd informonte Grey-n se gjëja e re që i kishte thënë S. Giuliano gjatë këtij takimi ishte se në marrëveshjen e propozuar midis Bullgarisë e Rumanisë, Bullgaria kishte pranuar parimin e mosndërhyrjes në çështjen e kucovllahëve të Maqedonisë dhe kishte dhënë garanci se ajo (Bullgaria)

¹⁵ *Po aty*, Telegram nga Vjena për Leihanec në Vlorë, 22 korrik 1913.

¹⁶ FO 371/1801, Ser Rennell Rodd për Ser Edward Grey, Romë 25 maj 1913.

¹⁷ *Po aty*.

do të konstituonte një precedent për njohjen e vllëve si një element i veçantë kombëtar. S. Giuliano mendonte që nëse Greqia ishte e gatshme të jepte të njëjtat garanci për vllëhtë, ishte e mundur që kundërshtimet austriake, gjë që do të thoshte edhe ata rumune, për përfshirjen e vllëve të Pindit në territorin e Greqisë, mund të tërhiqeshin. Kështu nuk do t'i jepej një kompensim Greqisë, përkundrajt bregdetit midis Vlorës dhe Kanalit të Korfuzit, për të cilin Austro-Hungaria dhe Italia nuk pranonin të bënin asnjë kompromis. Nga kjo bisedë Rennell Rodd kuptoi se çështja e kucovllahëve të Pindit ishte futur si një çështje që do të shërbente si një material për të bërë pazar me Mbretërinë Helene.¹⁸

Më tej për qeverinë britanike do të bëhej e qartë se në qëndrimet italiane dhe austro-hungareze, dy pika kardinale mbeteshin të pandryshueshme:

1- Njëra anë e Kanalit të Korfuzit duhej të përfshihej në Shqipëri; 2- Korça gjithashtu duhej t'i jepej Shqipërisë. Përveç këtyre ata kishin kërkuar që kucovllahët, të cilët formonin një bllok të madh në këtë rajon, duhej të bashkoheshin me Shqipërinë. Por, Grey mendonte se kishte të ngjarë që kjo kërkesë e fundit mund të kapërcehej nëse Greqia do t'u jepte garanci kucovllahëve për gjuhën, fenë dhe shkollat e tyre.¹⁹

Duke e ndjerë presionin austro-italian dhe rumun, i cili mund të konkretizohej me dhënien e gjithë territorit të banuar nga vllëhtë Shqipërisë, qeveria greke pranoi pa ngurrim se do të respektonte të drejtat e kësaj pakice. Ministri britanik në Athinë Sër F. Elliot pohonte se, “me qëllim që të plotësojë kërkesat rumune lidhur me kucovllahët e Pindit, të cilët thuhet se janë 1.200 vetë përballë një popullsie greke 120.000, qeveria greke ka propozuar t'u garantojë atyre të gjitha privilegjet që u janë dhënë vllëve në Bullgari sipas Protokollit të Shën Petersburgut”. Mirëpo premtimi grek ishte pritur me skepticizëm. Elliot informonte se ende nuk kishte ardhur ndonjë përgjigje nga qeveria rumune. Ai mendonte se “mesa duket ka disa pengesa që vijnë ose prej objektivave të larta të Rumanisë ose të mbështetësve të saj.”²⁰ Grekët vijuan t'i kërkonin Londrës mbështetje për zgjidhjen e kësaj situate, duke u ankuar për qëndrimet tendencioze të Austro-Hungarisë dhe të shteteve të tjera që kërkonin bashkimin e vllëve me Shqipërinë. Elliot informoi Grey-n se

¹⁸ Po aty.

¹⁹ FO 371/1801, E. Grey për Ser F. Elliot, FO 4 qershor 1913.

²⁰ FO 371/1801, Ser F. Elliot për E. Grey, Athinë 17 qershor 1913.

Koromilas ishte ankuar tek ai për interesin që po tregonte Austria për 1.200 kucovllahë të Pindit që nuk donin të përfshiheshin në Greqi, pa marrë parasysh se 120.000 banorë të tjerë të këtij rajoni ishin grekë.²¹

Sipas një dokumenti të mëvonshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme Italiane pohohej se në Konferencën e Fuqive të Mëdha në Londër, çështja vllahe u diskutua në datën 5 gusht 1913. Ambasadori i Austro-Hungarisë, me rastin e pranimin të pesë pikave që parashtrroi Sër Edward Grey në mbledhjen e mëparshme (për Jugun e Shqipërisë dhe ishullin e Korfuzit), përveç rezervave të tjera, shtroi edhe çështjen vllahe duke e formuluar në mënyrën që pason: “Lidhur me kucovllahët kabineti i Vjenës kërkon që t’i njihet Rumanisë mundësia për të mbrojtur të drejtat dhe interesat e tyre”²².

Edward Grey nënvizoi se *Rumania dhe Greqia duhej të merreshin vesh për garancitë që do t’u jepeshin kucovllahëve në territoret e aneksuara Greqisë dhe kështu nuk ishte e nevojshme që fuqitë të merrnin iniciativën*. Në mbledhjen pasuese më 8 gusht 1913, çështja u rikthye për diskutim, meqenëse ambasadori i Austro-Hungarisë e vuri pranimin e disa pikave si kusht për pranimin e formimit të një Komisioni Ndërkombëtar për caktimin e kufirit jugor shqiptar. Nga këto pika, e gjashta përcaktonte: “në zonën e banuar nga vllehtë, Komisioni do të konstatojë kombësinë e tyre dhe dhënia e këtyre territoreve Shqipërisë apo Greqisë, do të formojë objektin e një marrëveshjeje të drejtpërdrejtë midis Greqisë dhe Rumanisë”²³.

Duke iu përgjigjur deklaratave të ambasadorit të Austro-Hungarisë, Edward Grey propozoi se mund të liheshin këto dy fuqi të merreshin vesh drejtpërdrejtë mbi garancitë që do t’i jepeshin popullsisë së krahinave vllahe dhe se ishte e udhës të lihej çështja e përcaktimit të caqeve të territorit në dorën e fuqive. Si rrjedhojë, ai propozon redaktimin që vijon: Sa për zonën e banuar nga kucovllahët Komisioni duhet të konstatojë kombësinë e tyre. A do t’i takojnë, këto territore Shqipërisë apo Greqisë, këtë do ta vendosnin Fuqitë pas raportit të Komisionit Ndërkombëtar. Sa për garancitë që u duheshin dhënë popullsisë kucovllahe kjo do të ishte

²¹ FO 371/1801, F. Elliot për E. Grey, Athinë 17 qershor 1913.

²² *Archivio Storico Diplomatico di Ministero Affari Esteri*, Italia (më tej: AMAE), *Archivio Politico (AP)*, Serie Ordinario e di Gabineto (1915-1918), Pacco 7, F. Castoldi, Note circa la questione Valacca, 27 maj 1917.

²³ *Po aty*.

objekt i një marrëveshjeje të drejtpërdrejtë midis Greqisë dhe Rumanisë. Ky amendament u pranua nga ambasadorët më 11 gusht 1913.

Çështja vllahe iu la kështu Komisionit Ndërkombëtar për caktimin e kufirit jugor shqiptar. Komisioni duhet ta niste punën qysh në fillim por u konstatua se në luginat malore tani stina e ftohtë e bënte të pamundur të vizitoheshin ato krahina dhe nga ana tjetër popullsia që i ishte kushtuar blegtorisë, kishte filluar tashmë shtegtimin periodik drejt kullotave dimërore të Thesalisë dhe të Çamërisë. Ky ekzaminim për çastin u la mënjanë dhe u caktua për më vonë. Kështu Komisioni filloi punimet në vendet që i takonin kontestimit greko-shqiptar.

Po edhe këto punime më në fund u ndalën, pjesërisht nga qëndrimet greke, pjesërisht nga qëndrimi i delegatëve të Ruisë dhe të Francës. Kështu delegati anglez, koloneli Doughty-Wylie (Dati Uilis) u bë iniciator i një propozimi duke treguar një linjë kufiri që mund të formonte bazën e një marrëveshjeje të përgjithshme. Qeveria angleze, duke e bërë të vetën propozimin e delegatit të saj ua komunikoi kabinetëve të ndryshme. Në tekstin e komunikimit të saj përfshinte frazën që pason: *“Vllehtë, sipas marrëveshjes së propozuar, do t’i kalojnë Greqisë”*.

Qeveritë e Austro-Hungarisë dhe Italisë, duke iu përgjigjur shënimit anglez, përveç rezervave që lidheshin me pika të tjera, formuluan këtë rezervë lidhur me vllehtë: *“Çështja e territorit të banuar nga kucovllahët le të bëhet objekt i një marrëveshjeje të drejtpërdrejtë midis Greqisë dhe Rumanisë veçse të përcaktohet që tani se bisedimet që synojnë këtë marrëveshje nuk i japin Greqisë të drejtën për të vonuar zbrazjen e pjesës tjetër të territorit shqiptar përtej 31 dhjetorit të vitit në vazhdim.”*²⁴

Rumania do të pajtohej me vështirësi me lënien e krahinave vllahe në Greqi. Gjatë diskutimeve që bëheshin për pranimin e postit princëror të Shqipërisë, mbreti rumun, Karol, e lidhi miratimin e kandidaturës së Wied-it (Vidit) me përfshirjen e arumunëve në shtetin shqiptar. Ai i tha përfaqësuesit austro-hungarez se duheshin bërë të gjitha tentativat që arumunët e Greqisë t’i kalonin Shqipërisë sepse, po të mbeteshin me Greqinë, ajo, me gjithë premtimet e bëra, do të bënte gjithçka, madje nuk do të kursente as përdorimin e forcës për t’i helenizuar ata. Këtë bindje ai e kishte formuar kohët e fundit pasi raportet e ministrit rumun në Athinë flisnin me shumë pesimizëm për këtë çështje. Nga ana tjetër, Mbreti rumun ishte i shqetësuar se për çështjen e bashkimit të arumunëve me

²⁴ *Po aty.*

Shqipërinë parashikonte që Gjermania do të përkrahte pikëpamjen franceze, e cila ishte në favor të Greqisë.²⁵

Austro-Hungaria dhe Italia ishin mjaft të interesuara që shteti i ri shqiptar të kishte kufij të përshtatshëm nga pikëpamja strategjike për tu mbrojtur nga fqinjët dhe të ishte i aftë të mbijetonte nga ana ekonomike. Në këtë këndvështrim ato e vlerësuan si të rëndësishme edhe përfshirjen e minoritetit të vogël grek në këtë shtet. Ndërsa Franca dhe Rusia ishin shumë të interesuara që t'i akordonin sa më shumë territore Greqisë dhe t'u shërbenin politikave të saj për ekspansionin e helenizmit në Shqipërinë e Jugut.

Për të pasqyruar më konkretisht qëndrimin austro-hungarez është me interes të paraqesim udhëzimet që MPJ e Vjenës i dha delegatit austro-hungarez në Komisionin e Kufirit Jugor. Ndër to, thuhej se, Dropulli ishte i banuar prej grekëve. Por arsyet gjeografike, ekonomike dhe ato strategjike kërkonin që kufiri të paktën të vendosej 12 km në jug të Gjirokastrës, sepse: 1- rajoni bregdetar i akorduar Shqipërisë (kazaja e Himarës dhe e Delvinës) do të mbetej një rrip i ngushtë toke në buzë të detit që do të ishte vështirë për t'u mbajtur nëse hinterlandi (lugina e Gjirokastrës) do t'i caktohej një shteti tjetër; 2- rruga Delvinë-Gjirokastrë, që tek hani i Jorgucatit përmblihte pjesën e degëzuar të rrugës Delvinë-Janinë, duhej të mbetej e plotë dhe në një krahinë shqiptare; 3- Gjirokastra ishte qendra ekonomike për luginën dhe Saranda ishte porta, nëpërmjet së cilës gjithë krahina komunikonte me botën e jashtme.

Detyrë kryesore e Komisionit ishte të caktonte kufirin greko-shqiptar. Por për krahinat e banuara prej kucovllahëve, vendimet e Londrës kishin bërë përjashtim, në kuptimin që e detyronin Komisionin të konstatonte thjesht kombësinë e banorëve brenda projektit të kufirit të propozuar nga Austro-Hungaria dhe Italia, duke përfshirë brenda edhe krahinën e Pindit. Ndërsa vendimi se kujt shteti do t'i jepeshin këto territore rezervohej për t'u dhënë nga ana e kabineteve.

Në këtë çështje delegati austro-hungarez udhëzohej që konstatimet të influencoheshin gjithmonë në kuptimin pro vlleh, ashtu siç do të bënte për krahinat e tjera në favor të shqiptarëve. Veç kësaj, për të mos dëmtuar vendimin e mësipërm të Fuqive të Mëdha gjatë diskutimeve të

²⁵ *HHS.A.P.A.A.*, viti 1913, dos. 23-13, dok. 1301-1400, Hajmerle për kontin Berchtold, Sinaia, 18 shtator 1913.

Komisionit, ai duhej të vepronte në një mënyrë që të mbetej i hapur komunikimi midis krahinave që do t'i akordoheshin Shqipërisë dhe Pindit (eventualisht në krahinën e Konicës). Berchtoldi theksonte se këto ishin dëshirat e qeverisë së tij, për të cilat ai shpresonte se, në më të shumtën e rasteve, do të përputheshin edhe me pikëpamjet e fuqive të tjera. Por ai theksonte se ato, në vetvete, nuk përbënin asnjë karakter absolut dhe nuk duheshin mbrojtur në një mënyrë intrasigjente nga delegati austro-hungarez në Komision, pasi kështu do të vështirësohej puna e Komisionit, gjë që nuk ishte në favor të politikës austro-hungareze. Delegati austro-hungarez duhej të përpiqej t'ia arrinte këtij qëllimi duke bashkëpunuar me zgjuarsin me delegatët e tjerë të Komisionit dhe, atje ku do t'i duhej për të bërë koncesione, madhësinë dhe rëndësinë e tyre t'ia komunikonte kabinetit në Vjenë.²⁶

Gjatë diskutimeve joformale që bëheshin në shtator u diskutua çështja e Konicës dhe ajo e kucovllahëve që u mendua të lireshin të hapura. Konsulli austro-hungarez i Korfuzit theksonte se banorët e kësaj kazaje ishin pothuajse pa përjashtim grekë. Duke u nisur nga kriteri etnologjik, aneksimi i kësaj krahine, Shqipërisë do të ishte i pajustificueshëm. Por, ai vlerësonte disa argumente që mund të mbështesnin synimin austro-hungarez për t'ia dhënë këtë territor Shqipërisë. Këto ishin: shumica e popullsisë së vetë qytetit ishte myslimane; fshatrat e kësaj kazaje, ishin ekskluzivisht prona të bejlerëve myslimanë të Konicës; gjithashtu do të vihej në dukje se në rast se viset e banuara nga kucovllahët do t'i aneksoheshin Shqipërisë, për arsye gjeografike dhe strategjike, kazaja e Konicës, në asnjë mënyrë, nuk mund t'i jepej Greqisë. Konsulli i lartpërmendur austriak pohonte se, duke marrë parasysh konditat etnologjike në këtë krahinë dhe në krahasim me pozitën austro-hungarez absolutisht të favorshme në viset e tjera të kontestueshme, të gjitha këto pikëpamje duhej të konsideroheshin tepër të dobëta. Kështu që, ai dhe Labia, mendonin se do të ishte me vend që diskutimi i kësaj çështjeje të shtyhej sa të ishte e mundur, deri sa të ishte rregulluar çështja e Gjirokastrës. Gjithashtu ata mendonin se duke përjashtuar përkohësisht diskutimet për Konicën, kjo në të ardhmen mund të përdorej edhe si një objekt kompensimi. Ndërsa, për të

²⁶ *Po aty*, viti 1913, dos. 23-11 dok 1101-1200, Udhëzime të kontit Berchtold për delegatin austro-hungarez, në Komisionin Ndërkombëtar për caktimin e kufirit jugor dhe juglindor të Shqipërisë.

justifikuar përfshirjen e fshatrave grekofone të Gjirokastrës brenda shtetit shqiptar, pala austro-hungareze parashikonte të përdorte si kundërgument shkëputjen e viseve krejtësisht shqiptare të Çamërisë me afërsisht 80.000 shqiptarë. Gjithashtu ajo parashikonte që të propozonte shkëmbimin e popullsive midis këtyre dy krahinave. Eventualisht parashikohej që si objekt kompensimi mund të vlente edhe Konica.²⁷ Delegati austro-hungarez theksonte se kishte përkrahjen e delegatëve italianë e gjermanë për këtë projekt dhe shpresonte se do të përkrahej edhe nga delegati britanik, ndërsa përfaqësuesi rus mbante një qëndrim të ashpër kundërshtues. Delegati francez nuk e kishte marrë ende këtë propozim.

Nga raporti i lartpërmendur del gjithashtu se Greqia po bënte përpjekje të ethshme për të kundërshtuar vendimet e Konferencës së Londrës. Bilinski i shkruante Berchtoldit: “Autoritetet greke punojnë me të gjitha mjetet për të falsifikuar gjendjen reale të popullsisë së krahinave të kontestuara, dhe mbi shqiptarët po ushtrohet presioni më i madh. Vullnetarët e Epirit që kanë shërbyer në luftën e fundit u liruan zyrtarisht, porse ata u dërguan të armatosur në fshatrat ortodokse dhe myslimane, për të përgatitur banorët për ardhjen e Komisionit të kufijve. Çeta të shumta të komanduara edhe prej oficerëve po përshkojnë viset e kontestuara dhe porosisin banorët që të deklarohen para Komisionit si grekë. Prej Zagorie (në lindje të Janinës) dhe prej Konicës, banorët grekë dërgohen në Kolonjë dhe në viset e tjera që do të vizitohen nga Komisioni. Ata instalohen në ato fshatra shqiptare, banorët e të cilëve kanë emigruar nën presionin e terrorizmit grek ose janë arrestuar prej autoriteteve greke. Në Janinë janë përgatitur 5000 qeleshe të bardha shqiptare për t’ua shpërndarë grekëve të dërguar në krahinat shqiptare. Këtyre u jepen edhe kostume shqiptare që të paraqiten para Komisionit si shqiptarë grekofonë. Fshatrat shqiptare dhe vllahofone morën urdhra të rrepta që të përdorin vetëm gjuhën greke. Qeveria greke ka formuar edhe komitete të fshehta të cilat do të dërgojnë persona të besueshëm në fshatrat që do të vizitohen Komisioni, detyra e tyre do të jetë të vihen në dispozicion të Komisionit si “njohës të vendit” për të dhënë informata por njëkohësisht edhe për të influencuar banorët. Në Janinë dhe në Tepelenë mbahen të arrestuar mbi 50 vetë nga paria e Gjirokastrës, Delvinës, etj., me qëllim që në këto lokalitete të pakësohet numri i

²⁷ *Po aty*, viti 1913, dos. 23-9, dok 901-1000, Bilinski për kontin Berchtold, Korfuz më 17 shtator 1913.

shqiptarëve myslimanë me influencë. Myslimanët e Gjirokastrës kanë marrë urdhër që gjatë kohës së kalimit të Komisionit të qëndrojnë në shtëpitë e tyre dhe të mos duken nëpër rrugë. Autoritetet greke e deklarojnë fare hapur, bile edhe para përfaqësuesve të fuqive të huaja, se Greqia nuk do të lirojë vullnetarisht as edhe atë pjesë, që në bazë të vendimeve të Konferencës së Londrës, i është caktuar Shqipërisë...”.²⁸

Disa muaj më parë, qysh në maj, edhe konsulli austro-hungarez i Janinës kishte informuar se terrorizimi i popullsisë shqiptare në tokat e okupuara nga grekët po vijonte dhe në maj ishin bërë disa arrestime, krejtësisht të pamotivuara, të bejlerëve shqiptarë nga Çamëria, Leskoviku dhe Gjirokastra. Grekët po synonin të shmangnin çdo shprehje të ndërgjegjes shqiptare. Ishin arrestuar Fuat bej Pronja, Ali Kasemi, Veli Mahmuti, Iliaz Mehmeti, Eshref Mehmeti nga Paramithia, Vejsel Hyseni nga Margëlliçi. Ata ishin arrestuar me pretekst se ishin të dyshimtë dhe se kishin marrë pjesë në një konspiracion shqiptar. Ishin arrestuar edhe Ali Zot Aga, Vejsel Aga, Mehmet aga Alushi, Jasim aga Çalko, Lalo Ibrahim Aga nga Rashadija. Këta kishin shkuar në Pargë për të marrë pjesë në varrimin e një miku të tyre dhe ishin arrestuar e dërguar në Janinë. Në Leskovic ishte arrestuar kryetari i klubit të atyshëm shqiptar Rahmi bej Rusi, në Gjirokastër ishte arrestuar Bajram Beu.²⁹ Të gjitha këto dhe shumë informacione të tjera, që për arsye vendi nuk po i paraqesim në këtë studim, provojnë qartë se, krejt ndryshe nga minoritetet e huaja në Shqipërinë politike, të cilat nuk u prekën aspak, Greqia qysh në fillim ushtroi një dhunë të pashembullt për të mohuar identitetin e popullsisë shqiptare dhe të asaj vllahe dhe më vonë do të fillonte shumë shpejt procesin e dëbimit të tyre.

Gjatë caktimit të kufirit jugor në terren delegati anglez i kërkoi E. Grey-t që, me një ndihmë financiare, të mundësohej instalimi i banorëve të fshatrave greke të fushës së Gjirokastrës në Çamëri dhe i shqiptarëve të Çamërisë në këtë zonë. Gjithashtu ai propozoi që vija e kufirit të fillonte prej kazasë së Korçës, të vijonte përgjatë vargut të Gramozit, në të djathtë të rrugës prej Kolonje në Kalabaki deri në Vjosë dhe pastaj të vijonte në përputhje me vijën e caktuar nga projekti austro-hungarez dhe italian deri në Ftelia. Ai shtoi se një akord midis Fuqive për këtë vijë kufitare do të

²⁸ *Po aty*.

²⁹ *Po aty*, dos. 23-12, dok.1201-1300, Konsulli austro-hungarez në Janinë për kontin Berchtold, Janinë, më 19 maj 1913.

ishte i mundshëm në qoftë se ato do të jepnin siguri që t'i caktohej Greqisë territori i banuar prej kuovllahëve.³⁰

Austro-Hungaria ishte e prirur të propozonte shkëmbimin e grekofonëve të fushës së Gjirokastrës me banorët shqiptarë të Çamërisë, duke dhënë edhe ndihma në të holla për realizimin e këtij shkëmbimi. Delegati austro-hungarez e çmonte çështjen e zotërimit të fushës së Gjirokastrës si një problem gati jetësor për shtetin e ri shqiptar. Ndërsa, emigrimin e grekofonëve në Greqi e cilësonte si të favorshëm për shtetin shqiptar, pasi kështu ai do të çlirohej nga një element i disponuar për trazira dhe propagandë greke e cila ishte tepër aktive në këto krahina. Me largimin e grekofonëve propaganda greke do të humbiste shumë terren. Nga ana tjetër, në rast se parimi i kompensimit do të shtrihej edhe me emigrimin në Shqipëri të shqiptarëve të Çamërisë, atëherë shtetit të ri do t'i jepej në vend të një popullsie irredentiste greke, një popullsi patriotike me ide të njëjta kombëtare me shumicën shqiptare, gjë që nga pikëpamja e politikës së brendshme të Shqipërisë ishte për t'u përshëndetur. Delegati austro-hungarez propozonte që ky shkëmbim të kryhej menjëherë. Popullsia që do të emigronte duhej të shpërblehej në të holla dhe zona e zbrazjes do të shtrihej prej jugut të fshatit Dervican deri në vargun e maleve të Çamandës. Shkëmbimi do të drejtohej nga një komision special, i cili duhej të përbëhej prej përfaqësuesve të Fuqive të Mëdha të interesuara dhe prej atyre të Shqipërisë e Greqisë. Delegati austro-hungarez ishte i prirur të mbështeste vetëm propozimin për emigrimin e popullsisë grekofone të fushës së Gjirokastrës për në Greqi por, në se Ministria e Jashtme e tij e gjente me vend, ai pohonte se ky propozim mund të bëhej në çdo kohë edhe për emigrimin e çamëve për në Shqipëri. Ai analizonte edhe pasojat që do të kishte propozimi austro-hungarez në rast se ai do të hidhej poshtë nga fuqitë e tjera dhe grekët e Gjirokastrës nuk do të emigronin por do të mbeteshin në viset e Shqipërisë, me qëllim që të lehtësonin e ndihmonin edhe në të ardhmen propagandën panhelenike dhe veprën e saj në Epir. Atëherë propozimi i lartpërmendur do të ndihmonte që problemi i vështirë i Gjirokastrës të zgjidhej në një mënyrë që t'i përshtatej plotësisht interesit austro-hungarez. Në mënyrë të

³⁰ *Po aty*, viti 1913, dos. 23-5, dok 501-600, MPJ Vjenë për kontin Mensdorff në Londër, Vjenë, 8 nëntor 1913.

veçantë, ai do të ishte një objekt i çmueshëm kompensimi në bisedimet që zhvilloheshin për përcaktimin e kufirit në terren.³¹

Anëtari austro-hungarez i Komisionit e pranoi vijën britanike por deklaroi se për çështjen kuovllahe ai nuk ishte kompetent. Ai më tej informoi ministrin austro-hungarez në Romë, kontin Ambrozi dhe i kërkoi që të bisedonte me kabinetin italian, duke shtuar mendimin e tij se vija e propozuar nga përfaqësuesi britanik dhe propozimi i tij për shkëmbimin e shqiptarëve me grekët dukeshin relativisht të pranueshme, ndërsa për çështjen e vllahve duheshin shprehur disa rezerva në interes të Rumanisë. Ai sugjeronte që, për sa i përket territorit të banuar prej kuovllahëve, të respektoheshin rigorozisht vendimet e Londrës.

Edhe markezi Di San Guliano informoi se ishte dakord me dy propozimet e para britanike. Ndërsa për çështjen e kuovllahëve edhe ai mendonte që kjo duhej shqyrtuar me kujdes. Austriakët kishin frikë se propozimi anglez do të kundërshtohet në Paris, pasi mund të konsiderohej si pak i favorshëm për Greqinë dhe Franca mund ta nxiste Anglinë t'u drejtohej Fuqive të Mëdha me një projekt të modifikuar në favor të Greqisë. Për këtë arsye austriakët dhe italianët ranë dakord që të bënin sondazhe në Londër se çfarë mendonte E. Grey për propozimin në fjalë. Më vonë qeveria britanike bëri një propozim tjetër i cili ishte më pak i pranueshëm për austriakët.³²

Një raport më të detajuar për çështjen vllahe bënte disa ditë më vonë Buchberger (Buhberger) të cilin ia dërgoi kontit Berchtold në Vjenë.³³ Në kompleksin e çështjeve që kishin të bënin me rregullimin e kufirit të Shqipërisë së Jugut, rajoni i banuar nga kuovllahët formonte një pjesë të veçantë. Nga parashikimet e austriakëve presupozohej se do të mbetej jashtë kufirit shqiptar territori që cilësohej si rajoni kuovllah. Por, nga ana tjetër ai bënte këtë përshkrim të detajuar të fshatrave vllahe dhe argumentet që mund të parashtroheshin në favor të përfshirjes së tyre në shtetin shqiptar:

- Ky rajon kishte formën e një trekëndëshi, krahët e të cilit i formonin fshatrat Slimicë dhe Pilkat në luginën e Belicës dhe baza e tij

³¹ *Po aty*, viti 1913, dos.23-14, dok.1401-1500, Buhberger për kontin Berchtold, Leskovik, 16 nëntor 1913.

³² *Po aty*, viti 1913, dos. 23-5, dok 501-600, MPJ në Vjenë për kontin Mensdorff në Londër, Vjenë, 8 nëntor 1913.

³³ *HHSSt.A.P.A.A.*, viti 1913, dos. 23-5 dok 501-600, Buhberger për kontin Berchtold, Leskovik, 16 nëntor 1913.

ndodhej midis Baltinonit në Lindje dhe Zovrës në Perëndim. Këtë zonë ai e ndante në tre grupe.

- I) Njëri në jugperëndim, krahina në Zagori (kazaja e Janinës), e cila ndodhej në pjesën e sipërme të Vojsmatit dhe ndiqte vijën e ujërave të përrenjve që më tej bashkoheshin në lumin e Artës.
- II) Tjetri në jug-lindje, që ishte krahina e Vllahisë në faqet lindore të Pindit e që bashkohej me rajonet e luginës së Vjosës të banuara prej arumunëve dhe me ato të shpatit jugor të Smolikës.
- III) Një grup tjetër i ndodhur në veri të dy grupeve të lartpërmendur, i kufizuar prej Sarandoporit në Jug dhe Belicës në Veri, përmblihte fshatrat Paljoksa e Paljokimero në Lindje dhe Arinën në Perëndim.

- Krahina e Zagorisë përfshinte 8 fshatra thjeshtë vllahe të cilat ishin: Trstenik, Grebeniti, Flamburari, Dragari, Makrini, Shehi, Cermeshi dhe Vojusa. Austriakët vërenin se, nën influencën e propagandës greke, pjesa më e madhe e Zagorisë ishte greqizuar dhe ideja kombëtare vllahe atje kishte humbur gati krejtësisht. Në më të shumtat e fshatrave të Zagorisë flitej ekskluzivisht gjuha greke, me përjashtim të fshatrave të lartpërmendura.

- Në krahinën e Vllahisë ishin 11 fshatrat e poshtëshënuara të cilat flisnin që të gjitha vllahisht: Samarina, Smiksi, Avzala, Perivoli, Labanica, Kranja, Milja (Ameru), Kueufljani, Baltnon dhe Bozvo. Disa prej tyre si Samarina, Avzela dhe Perivoli ishin mjaft të populluara dhe kishin një rëndësi të madhe. Popullsia e fshatrave të lartpërmendura, të ndodhura në kazanë e Grebenesë, formonin më tepër se gjysmën e popullsisë së përgjithshme të kësaj kazaje. Këto fshatra e kishin ruajtur të pastër karakterin etnik vllah dhe aspiratat kombëtare jetonin të forta. Greqishtja thujse nuk njihej në këtë zonë dhe flitej vetëm nga një pakicë. Pikërisht popullsia kuco-vllahe e kësaj zone kishte luftuar për vite me radhë kundër propagandës dhe terrorit grek. Madje ajo kishte formuar çeta kombëtare kundër çetave greke që ishin dërguar në ato vise. Ky fakt ishte për t'u shënuar, duke pasur parasysh karakterin dhe traditën paqësore të fiseve vllahe. Për shkak të masakrave të kryera para disa viteve prej bandave greke në këto krahina (masakra e Avzelës) Rumania kishte vendosur që të zhvillonte një propagandë të ethshme në favor të vllahëve otomanë, madje kishte shkuar aq larg sa kishte acaruar marrëdhëniet e saj me Greqinë.

- E njëjta gjë mund të thuhet edhe për fshatrat që ndodheshin në shpatin jugor të vargmalit të Smolikës, megjithëse ideja kombëtare këtu nuk ishte manifestuar në një mënyrë të qartë. Këto fshatra ishin: Armata, Paç, Paljozeli dhe Grizbani. Në këtë grup përfshiheshin edhe pesë fshatrat e ndodhura në luginën e Vjosës: Brjaza, Paljohri, Lesnica, Dobrinovo dhe Lajsta.

- Në grupin e tretë midis Sarandaporit dhe Belicës ndodhej një fshat i vetëm kuovllah Gramorta. Pjesa tjetër e popullsisë së këtij grupi ishte shqiptare ose bullgare. Një pjesë e tyre ishin ortodoksë që vareshin nga Patrikana Greke dhe paraqiteshin prej grekëve si grekë.

Në relacionin e delegatit austro-hungarez thuhet se, përveç këtyre fshatrave, kishte edhe fshatra bullgare e shqiptare dhe ky grup nuk mund të cilësohej i tëri si vllah. Aneksimin e tij me Shqipërinë ai e konsideronte të drejtë, aq më tepër, pasi edhe Rusia dukej se ishte e disponuar të bashkonte fshatrat sllave të kontestuara me Shqipërinë. Zona tërësisht vllahe ai cilësonte ato të Zagorisë dhe Vllahisë në grupin e I dhe të II që kishin 28 fshatra thjesht vllahe. Përveç popullsisë autoktone stabile vllahe në atë krahinë dhe kryesisht në Pind, ishin edhe shumë fshatra verore, banorët e të cilëve në dimër shkonin në kullotat e vendeve më të ulëta, në Myzeqe, në Çamëri etj. Nga pikëpamja ekonomike ky grup nomadësh që ishte i organizuar sipas familjeve, nën drejtimin e një kryetari, kishte një rëndësi të posaçme në ato krahina. Profesionit i blegtorisë që ushtrohej prej kësaj popullsie dhe industria dytësore që funksiononte në lidhje me të (përgatitja e djathit dhe endja e pëlhurave etj.) ishin një faktor produktiv i rëndësishëm në jetën ekonomike të këtyre viseve. Pikërisht për këtë arsye, theksonte ai, do të ishte shumë i rëndësishëm aneksimi i gjithë zonës kuovllahe në Shqipëri pasi, në këtë mënyrë, këtij shteti të ri do t'i bashkohej një element i butë që do t'i jepte gjallëri tregtisë.

Ai i propozonte Berchtoldit se ishte e domosdoshme që grupi i parë i vllahve të bashkohej me Shqipërinë. Në këtë rast kufiri duhej të shkonte prej Paljokrimeras (kuota 1792) duke ndjekur majat e maleve në drejtim të jugut (kuota 1262) dhe pastaj në drejtim të perëndimit (kuota 1883) duke shkuar gjatë vargut të maleve Smolika (1760; 3564) Zaras (1564) Shushanica (1212) dhe të arrinte Sarandoporin. Përfshirja e disa fshatrave greke brenda kësaj vije kufitare ishte e paevitueshme për arsye të natyrshme gjeografike, por kishte mundësi që ky veprim të gjente justifikim edhe me ndarjen e pasurisë së patundshme e cila kryesisht u

përkiste myslimanëve shqiptarë. Kufiri i propozuar më lart do të ishte i natyrshëm pasi do të kalonte në majat e maleve të një vargmali.

Delegati austro-hungarez parashikonte se do të kishte kundërshtime për përfshirjen në Shqipëri të grupit I dhe II, duke u ngritur pretendime se popullsia, pjesërisht e greqizuar e tyre, do të përbënte vetëm një element turbullues dhe të pakënaqur në shtetin shqiptar. Ai sugjeronte që kundrejt këtij argumenti duhej bërë vërejtja se shumica e popullsisë së dy grupeve në fjalë, sidomos e Vllahisë, ishte vllahe dhe se ajo e kishte ruajtur karakterin kombëtar të saj.³⁴

Ministri i Jashtëm austro-hungarez, Berchtold informoi diplomatët e tij se qeveria austro-hungareze dhe ajo italiane do t'i përgjigjeshin qeverisë britanike me një notë në të cilën do të aprovohej propozimi britanik dhe se çështja e territorit të banuar prej kuovllahëve duhej të bëhej objekt i një marrëveshjeje direkte midis Rumanisë dhe Greqisë por, me kusht që këto bisedime nuk do t'i jepnin të drejtën Greqisë, të shtynte datën e zbrazjes së territorit shqiptar përtej datës 31 dhjetor 1913.³⁵ Berchtoldi informoi Ambrozin në Romë dhe Buchberger-in në Leskovik se delegati francez, në mënyrë jo obliguese, kishte zhvilluar bisedime me delegatët austro-hungarezë dhe italianë dhe kishte thënë se ishte i predispozuar të pranonte vijën e propozuar nga delegati austro-hungarez në jug që shkonte deri në Malin Tumba (kuota 2300 m) dhe në veri, duke përjashtuar zonën kuovllahe, vijën e Gramozit deri në Arina. Kështu që mbetej për t'u caktuar ende vija Tumba - Arina - Kaza e Leskovikut dhe një pjesë e kazasë së Konicës.

Kur u vendos që të fillonte përcaktimi i kufirit në zonën e Korçës, përfaqësuesi i qeverisë britanike propozoi që çështja e përfshirjes së vllahëve në territorin shqiptar ose grek të shtyhej dhe kjo kërkesë u mbështet nga përfaqësuesit e Francës dhe të Ruisë. Më vonë me këtë mendim u bashkua edhe përfaqësuesi i Gjermanisë.

Vija e projektit austro-hungarez për sa i përket fushës së Gjirokastrës do të pranohej me kusht që të bëhej i mundshëm, nëpërmjet një subvencionit, instalimi i banorëve të fshatrave greke të kësaj fushe në Çamëri dhe anasjelltas. Berchtoldi ishte informuar nga Buchberger se në bisedimet zyrtare që do të zhvilloheshin, duke u rezervuar për sa i

³⁴ *Po aty.*

³⁵ *Po aty*, Udhëzime të Berchtold për kontin Mensdorff në Londër, për fon Merey në Romë dhe për Buchberger në Leskovik, Vjenë, 24 nëntor 1913.

përkiste territorit kucovllah, me anë të koncensioneve reciproke, duhej synuar që të arrihej një lidhje midis maleve Arina dhe Tumba me anë të lumit Sarantoporos. Lumi në fjalë formonte, nga pikëpamja etnografike, gjeografike dhe strategjike, një kufi natyral dhe bënte të mundshëm lidhjen e kucovllahëve me tokën shqiptare gjatë vijës Sarantoporos - kufiri kazaja e Korçës. Berchtoldi pohonte se një kufi që do të nisej prej kazasë së Korçës mbi vargun e Gramozit, Arina Sarantoporos deri në Tumba dhe prej andej, në përputhje me propozimin austro-hungarez e italian të shkonte deri në Ftelia, do të ishte i pranueshëm, me kushte që, për sa i përkiste territorit kucovllah, Austro-Hungaria do të kërkonte më parë aprovimin e Rumanisë dhe të mbetej i pandryshuar afati i caktuar në Londër për zbrazjen e territorit shqiptar prej grekëve.³⁶

Në vjeshtën e vitit 1913 edhe qeveria britanike po e shqyrtonte imtësisht çështjen e vllahve. Foreign Office po diskutonte madje edhe çështjen e krijimit të një shteti vllah. Anëtari britanik në Komisionin e Kufijve C. H.M. Doughty-Wylie u porositi nga E. Grey për të bërë hetime mbi mundësinë e krijimit të një shteti të pavarur vllah.³⁷ Wylie bëri diskutime të gjata me konsullin e përgjithshëm rumun në Manastir Jonesku, përpara se ai të largohej në Bukuresht. Jonesku i shpjegoi atij se vllahve iu ishin premtuar liri të plota për shkollat dhe kishat nga Greqia dhe Serbia. Por, ai shpresonte se Komisioni i Kufijve do të vendoste bashkimin e një territori të gjerë që përfshinte gjithë malësinë e Pindit, që nga Janina në Jug deri në Tista në Lindje, me Shqipërinë.

Rumania preferonte që vllahët të futeshin në shtetin shqiptar pasi besonte se Fuqitë do t'i impononin shqiptarëve garantimin e funksionimit të lirë të shkollave dhe kishave vllahe. Ky qëndrim i qeverisë rumune lidhej me mosbesimin që kishte ajo ndaj premtimeve të shteteve të tjera ballkanike për qëndrime tolerante. Kryeministri rumun Jonesku, duke pasur parasysh afrimitetin e Serbisë me Rumaninë, besonte se ajo do t'i respektonte garancitë që kishte dhënë për funksionimin e shkollave dhe kishave vllahe. Ndërsa ai nuk besonte në garancitë që kishte dhënë Greqia. Ai ishte i bindur se asnjë prift grek, pavarësisht se çfarë kishte premtuar qeveria greke, nuk do të lejonte asnjë liturgji që të mbahej në

³⁶ *Po aty*, viti 1913, dos.23-14, dok.1401-1500, konti Berchtold për kontin Ambrozi në Romë dhe Buhberger në Leskovik, 18 nëntor 1913.

³⁷ FO 371/1803, C. H.M. Doughty-Wylie, shënim mbi çështjen e vllahëve dërguar Eduard Grey-t, Manastir, 2 tetor 1913.

gjuhën vllahe. Në Komisionin e Kufijve ende kishte paqartësi se cilat ishin pikëpamjet e qeverisë britanike për çështjen e vllëve. Wylie shkruante se “kolegët e mi këtu në Komision janë të interesuar të dinë se cilat janë udhëzimet tona për të përcaktuar kombësinë e vllëve”. Disa prej tyre mendonin se qeveria britanike do të prononcohej për kombësinë e vllëve në të gjithë rajonin e lartpërmendur nga Jonesku. Të tjerët, përderisa punimet e Komisionit ishin të kufizuara që të mos kalonin në jug të vijës së përcaktuar nga Austria ose Kazasë otomane të Korçës, e kuptonin se qeveria britanike kishte vendosur të shqyrtonte vetëm ato fshatra që ndodheshin në veri të kësaj vije.

Gjithsesi, dukej se shqyrtimi i mëtejshëm i kësaj çështje do të shtyhej për arsye të dimrit që po afrohej. Wylie i shkruante Grey-t se këtë vit ishte shumë vonë për të shkuar në malet e Pindit, ku madje dhe vetë vllëhtë po zhvendosen në kullotat e tyre në Thesali dhe afër Prevezës. Komisioneri britanik kishte marrë udhëzime të hetonte edhe për sjelljet e vllëve pasi propaganda greke e kishte paraqitur këtë popullsi me ngjyra të errëta. Duke pasur parasysh edhe këtë çështje ai e përforconte sugjerimin për ta shtyrë udhëtimin në malësinë e Pindit, duke argumentuar se “një mal i zbratur nga njerëzit nuk mund të prodhojë banda dhe hajdutë dhe vllëhtë në fakt duket se kanë një reputacion shumë të respektuar të popujve të ndryshëm që jetojnë në këto vende. Kështu është më mirë që të presim deri në pranverë në qoftë se pjesa tjetër e Komisionit ka opinionin tim”.³⁸

Gjithashtu, delegati britanik vlerësonte lart edhe resurset ekonomike të rajonit të banuar prej vllëve. Ai i shkruante Grey-t: “Lidhur me çështjen e përgjithshme të attributeve të territoreve vllahe, duhet pasur parasysh se rajoni, duke u nisur nga taksat që ka paguar më parë është i pasur. Unë jam informuar se taksa e bagëtive në kohën turke (agnam) që merrej prej vllëve mbante gjithë administratën e Maqedonisë ose një pjesë të madhe të saj”.³⁹

Ndërkohë diskutimet midis komisionerit britanik dhe sekretarit të Jashtëm vijonin dhe çështja e vllëve ende ishte e paqartë. Wylie shprehej optimist për mundësinë e arritjes së një marrëveshjeje për këtë çështje por duke u bazuar në disa kushte të reja. Për këtë arsye ai pyeste shefin e diplomacisë britanike nëse kishte mundësi që Komisioni

³⁸ Po aty.

³⁹ FO 371/1803, Doughty-Wylie për Eduard Grey, 11 nëntor 1913.

Ndërkombëtar i Kufijve të studionte këtë territor në të gjitha aspektet e veta ekonomike, strategjike, gjeografike me qëllim që të hartonte një rekomandim të përbashkët për kufirin, i cili t'i dërgohej Konferencës së Ambasadorëve?⁴⁰ Diskutimin e çështjes së kufirit në një shkallë të tillë më të gjerë e favorizonte edhe qëndrimi i delegacionit austro-hungarez. Wylie, informonte Grey-n, se kolegu austriak i kishte sugjeruar privatisht që grekët e Gjirokastrës mund të zhvendoseshin, duke i këmbyer me myslimanët që janë më në jug të kësaj krahine. Ndërsa vetë Wylie mendonte se krahina e ashpër e vllahve dhe Konica mund t'i jepen Greqisë, pjesa që mbetet t'i kalonte Shqipërisë.⁴¹

Më 1 nëntor, Doughty-Wylie i paraqiti Grey-t një tablo më të gjerë të situatës etnografike në territorin e banuar nga vllahët dhe mendimet e prirjet e delegacioneve të Fuqive të tjera për ndarjen e këtij territori.⁴² Duke ju referuar raportit të ekspertit italian Castoldi, ai shkruante se, territori vllah ndahej në 3 seksione. Njëri prej tyre ishte helenizuar në një shkallë të tillë sa që ai natyrisht duhej t'i kalonte Greqisë. Seksioni i dytë banohej nga vllah, të cilët ruanin akoma gjuhën dhe ndonjë ndjenjë fetare. Wylie sugjeronte që edhe ky duhej t'i jepej Greqisë, nën garanci të rrepta për respektimin e të drejtave të popullsisë vllahe. Ai shtonte se ekzistonin arsye gjeografike por edhe politike për këtë koncesion që do t'i bëhej Greqisë. Wylie pohonte se kapiten Castoldi, i cili natyrshëm ishte vlerësuar si komisioner i njëanshëm nga pala greke, kishte thënë se bashkimi i 11 fshatrave në Kazanë e Grebenesë, me Greqinë do të ishte i vështirë. Por Wylie ishte informuar privatisht se, nëse Greqisë do t'i imponoheshin garancitë e lartpërmendura dhe nëse do të arrihej ndonjë marrëveshje për seksionin verior, qeveria italiane dhe austriake nuk do të kundërshtonin dhënien Greqisë të seksionit të mesëm vllah.

Seksioni verior, domethënë territori i ashpër në veri të Sarandaporos, nuk ishte një vend që banohej tërësisht prej vllahve. Në këtë territor ekzistonte një fshat i madh vllah që përdorej për kullotë në verë. Por fshatrat e tjerë ishin shqiptare dhe bullgare. Kështu Wylie propozonte që kjo pjesë mund t'i jepej Shqipërisë. Ai kishte paraqitur në hartë vijën ndarëse të kufirit, e cila shkonte përgjatë luginës së

⁴⁰ FO 371/1803, Lejtnant kolonel Doughty – Wylie për Eduard Grey, Kolonjë, 26 tetor 1913.

⁴¹ Po aty.

⁴² FO 371/1803, Lejtnant Kolonel Doughty-Wylie për Eduard Grey, Ersekë, 1 nëntor 1913.

Sarandaporos në kryqëzimin e rrugës së Përmetit me Leskovikun, drejt një pike të fshatrave Kukesi dhe Biltok, pastaj vijonte në veri drejt Bobicko, Golos, dhe më tej mbi majën 1094 m drejt majës 1088 m (Priasio Tepesi). Prej këtej vija ndiqte kufirin e vjetër të vilajetit turk të Janinës, përreth ujërave të Sarandaporos dhe shkonte drejt vijës së propozuar nga përfaqësuesi austriak e cila në këtë hartë ishte shënuar me ngjyrë të kuqe. Kjo vijë ishte shënuar me detaje edhe në memorandumun e komisionerit italian, Castoldit.

Interesant ishte edhe qëndrimi i komisionerit rus Levkoviç i cili, i interesuar për çështjen e fshatrave bullgare, dëshironte që kjo zonë t'i jepej Shqipërisë, sepse ai mendonte se sllavët, nën sundimin grek, do të detyroheshin të pranonin kombësinë greke, gjuhën, shkollat dhe priftërinjtë grekë. Ky ishte një koment shumë interesant nga atasheu ushtarak rus në Athinë, i cili kishte qenë së bashku me ushtrinë greke dhe ishte përcjellë si një mik i Greqisë. Në të vërtetë ky mendim shpjegon edhe prirjen e disa fuqive të cilat mendonin se pakicat mund ta mbronin më lehtësisht dhe më me sukses identitetin e tyre brenda shtetit shqiptar meqë ky do të ishte përgjithmonë më i dobët dhe, si i tillë, më i paaftë të ndiqte politika nacionaliste të spastrimit etnik siç po vijonin të bënin me sukses disa shtete më të forta ballkanike. Por nga ana tjetër, koloneli Levkoviç kishte refuzuar që komisioneri britanik ta paraqiste këtë rektifikim në Komision si një propozim të tijin. Wylie mendonte se ai veprimi kështu pasi mund të gjendesh në një pozitë të vështirë me kolegun e tij francez dhe me Athinën. Për Rusinë rektifikimi mund të kishte gjithashtu avantazhe të mëdha. Ai mund të ishte një lidhje e qartë midis Shqipërisë së re dhe rajoneve vllahe të Samarinës etj., të cilat do të mbeteshin në duart e Greqisë. Nga pjesa veriore e vendit, p.sh. nga Gramosta mund të vëzhgohesh nga afër respektimi i privilegjeve që do t'i akordoheshin vllahëve nga Greqia nën garancinë e Rusisë.⁴³

Por, nga ky modifikim do të rezultonte edhe një disavantazh i dukshëm pasi, nëse francezët do ta pranonin modifikimin, ata mund të kërkonin kompensim për Greqinë diku gjetkë. Ky kompensim ishte vështirë të gjendej. Përfaqësuesi francez, Labia dëshironte që rajone të rëndësishme në veri të Voshtinës të bashkoheshin me distriktin e Pogonit. Por ky mendim do të kundërshtohej nga kolegu austriak. Edhe Wylie mendonte se nga harta dukej se kishte arsye strategjike të forta për të

⁴³ Po aty.

kundërshtuar këtë synim. Ai i propozonte Grey-t që qeveria britanike të mos e mbështeste këtë dëshirë të francezëve. Ai mendonte se kishte të ngjarë që francezët do ta braktisin kërkesën që territori në veri të Sarandaporos t'i jepej Greqisë.

Por, Wylie mendonte se një pretendim i mundshëm francez për një kompensim të mëtejshëm të Greqisë me një territor në veri të Sarandaporos, mund të rezultonte me një vlerë relative për politikën britanike. Në rajonin e Pogonit që ishte dorëzuar nga Italia kishte 12 fshatra të cilat do të bëheshin pronë direkte e qeverisë greke. Këto fshatra dikur kishin qenë pronë private e Ali Pashë Tepelenës, të cilat shteti turk më vonë ia kishte marrë atij dhe i kishte futur në listën civile të pronave të tij. Qeveria greke i trashëgoi këto fshatra nga Turqia. Kishte edhe fshatra të tjerë si këto në Kazanë e Konicës dhe në një pjesë të Leskovikut, të cilat ishin poshtë vijës së propozuar nga përfaqësuesi britanik dhe do të bëheshin pronë e shtetit grek. Megjithëkëtë, Wylie ishte ende i paqartë nëse duhej bërë diçka për rritjen e shumës që do të paguhej për kompensimin e Gjirokastrës.

Për t'ia bërë më të qartë tablonë Grey-t, ai i paraqiti dy lista të fshatrave vllahe të cilat ishin përpiluar sipas të dhënave italiane dhe rumune.⁴⁴

Megjithëkëtë, Grey ende nuk ishte i qartë për çka po i shkruante Wylie dhe ai theksonte se ende nuk mund t'i jepte atij udhëzime përfundimtare. Ai e porositi komisionerin britanik që nëse zgjidhja e përgjithshme varej nga zgjidhja e çështjes vllahe, atëherë duhej pasur parasysh se Konferenca e Ambasadorëve kishte vendosur që Komisioni i Kufijve duhej të raportonte për kombësinë në distriktin vllah. Pas kësaj dhënie e këtij territori Shqipërisë apo Greqisë do të vendosej nga Fuqitë. Kështu që Komisioni duhej ta trajtonte çështjen vllahe menjëherë.⁴⁵

Konfuzioni i sekretarit të Jashtëm britanik u shtua më tej pasi filluan t'i vinë përgjigje nga Fuqitë e tjera të Mëdha të cilat pohonin se delegatët e tyre në Komisionin e Kufijve Jugor kishin marrë sugjerime të tjera prej delegacionit britanik për të cilat Grey mendonte se ishin ato që ishin paraqitur në telegramin e Wylie nr. 13, të datës 30 tetor. Grey shtonte se disa qeveri nuk ishin të qarta nëse ky ishte propozimi i sekretarit të Jashtëm britanik apo sugjerime që kishte bërë vetë

⁴⁴ Po aty.

⁴⁵ FO 371/1803, Eduard Grey për Doughty-Wylie, Londër 3 nëntor 1913.

delegacioni britanik në Komisionin e Kufijve. Ai i konsideronte sugjerimet e telegramit të lartpërmendur të Wylie si një plan të tijin më të detajuar për t'i dhënë një efekt më praktik skemës së tij të përgjithshme, e cila ishte paraqitur në një telegram të mëparshëm të Wylie me nr.7.

Duke dashur ta rikapitulonte gjithë korrespondencën Grey shtonte se e kishte kuptuar në këtë mënyrë propozimin e fundit të Wylie:

- a) Kufiri do të ndjekë një linjë të përcaktuar nga mali Gramoz në drejtim të Perëndimit
- b) Popullsia greke dhe myslimane e rajoneve në fjalë do të zhvendoset përtej kufijve në mënyrë reciproke dhe do të marrin kompensim.
- c) Vllhët deri te lumi Sarandoporo do t'i jepen Greqisë, ata në veri të këtij lumi do t'i jepen Shqipërisë.⁴⁶

Delegati britanik e sqaroi më tej shefin e diplomacisë britanike se propozimet e tij, të cilat kishin qenë krejt jozyrtare, nuk ishin ashtu siç përshkruheshin në telegramin e Grey-t nr.12, dt.11 nëntor. Kufiri i propozuar prej tij shkonte në jug të rajonit të Korçës, në kreshtën e Gramozit. Kjo pikë duhej përcaktuar gjeografikisht.⁴⁷

Shkëmbimi i popullsive greke e myslimane me kompensim ishte propozuar nga kolegët austriakë e italianë. Ndarja e rajonit vllah ishte sugjeruar vetëm nga kolegu italian. Vija në perëndim të Gramozit që e fuste Leskovikun në Greqi ishte një sugjerim francez. Ndërsa vija e propozuar nga Wylie kishte pasur si qëllim që të shërbente si një bazë për marrëveshje, pa të cilën nuk mund të bëhej ndonjë progres në të ardhmen, por ajo mund të modifikohej me detaje të tjera topografike gjatë turit që do të zhvillonte Komisioni i Kufirit në terren.⁴⁸

Gjithsesi dukej se për këtë çështje Fuqitë ishin afër arritjes së një marrëveshje. ndihmësministri rus i Punëve të Jashtme i premtoi përfaqësuesit britanik në Shën Petersburg se do t'i dërgonte udhëzime delegatit rus që ai të vepronte si delegati britanik, në qoftë se kolegët e tjerë ishin udhëzuar në mënyrë të ngjashme. Ndhmësministri rus ishte informuar nga i ngarkuari me Punë i Italisë se ishte diskutuar një propozim i paraqitur nga delegacioni britanik në Komisionin e Kufijve.

⁴⁶ FO 371/1803, Eduard Grey për Lejtnant Kolonel Doughty-Wylie, 11 nëntor 1913.

⁴⁷ FO 371/1803, Doughty-Wylie për Eduard Grey, Leskovik 13 nëntor 1913.

⁴⁸ Po aty.

Sipas këtij propozimi, kufiri duhej të ndiqte një vijë të përcaktuar, nga malet e Gramozit drejt perëndimit; popullsia greke dhe myslimane e distrikteve në të dy anët duhej të zhvendosej në mënyrë reciproke përtej kufirit, duke marrë kompensime; dhe vllhtë duhej t'i jepeshin Greqisë.⁴⁹ Këto ishin edhe sugjerimet që referoheshin në telegramin e delegatit britanik të datës 30 tetor. Përfaqësuesi italian në Rusi i kishte deklaruar ndihmësministrit të Punëve të Jashtme të Ruisë, se pikat 1 dhe 2 ishin të pranueshme për qeverinë italiane. Madje ndihmësministri rus mendonte se edhe qeveria austriake do të pajtohej me to.⁵⁰

Duket se në mesin e nëntorit britanikët arritën në fundin e qartësimit dhe diskutimit të çështjeve për kufirin në zonat e banuara nga vllhtë. Komisioneri britanik njoftonte Londrën se në distriktin Nr.11 ai kishte menduar një kufi i cili ja linte veriun e Sarandaporos, Shqipërisë. Ai propozonte që ky sugjerim duhej parashtruar para nga qeveria britanike dhe shtonte se ai buronte nga propozimet ruse dhe italiane dhe prekte interesat e Ruisë dhe Rumanisë. Delegati britanik shpresonte se kolegët e tij të delegacioneve të tjera do ta pranonin atë, megjithëse shprehte një rezervë lidhur me delegatin rus, i cili kishte ndryshuar mendim rreth kësaj çështje.

Në një takim të Komisionit, i organizuar nga delegati britanik koloneli Ladhemand dhe Labia ranë dakord me një vijë kufitare e cila kalonte afër zonës ku malësia e Gramozit pret kazanë e Korçës, pastaj shkonte përgjatë kreshtës së Gramozit, dhe ecte në drejtim të Mavri Petra.⁵¹ Prej këtij kufiri kalonte në drejtim J-JL përgjatë shpatit të Gramozit i cili quhej Arina në hartën e paraqitur nga stafi austriak dhe pastaj kalonte nga Mali Jokas. Duke pasur parasysh këtë marrëveshje, Wylie propozonte të rishqyrtonte pikëpamjen e tij të mëparshme për të bërë një modifikim për territorin vllëh në veri të Sarandaporos. Ai mendonte se kufiri i Shqipërisë në Priasipo Tepesi, jo vetëm që ishte një kufi i mirë nga pikëpamja gjeografike, por ai përfshinte në Shqipëri mjaft nga territoret vllahe për të formuar “trait d’union” (bashkimin) e dëshirueshëm.

⁴⁹ FO 371/1803, O' Beirne për Eduard Grey, Shën Petërburg, 9 nëntor 1913.

⁵⁰ Po aty.

⁵¹ FO 881/10492, Lejtnant kolonel D.Wylie për E. Grey. Leskovik, 16 nëntor 1913.

Meqë Priasipo Tepesi mund të pranohej nga të dyja palët, ai mendonte se do të ishte më mirë të modifikonte propozimin e tij fillestar, siç tregoi në telegramin e tij nr.11. Por natyrisht kishte shumë konsiderata të tjera, duke përfshirë ato të Rumanisë dhe Rusisë, në lidhje me këtë territor vllah, të cilat britanikët ende nuk i dinin. Ai gjithashtu informonte se në Maljokas kishin filluar edhe kundërshtimet midis kolonelit Ladhemand dhe delegatit Labia. Labia dëshironte ta zbriste kufirin në lumin Sarandoporos afër Kastanjonit, më tej në malin Susnica, duke mbajtur përgjithësisht drejtimin jugor, në Voyusa afër Grizbanit, pastaj kufiri do të zbriste në pikën 1564 në malin Gamila, ku vija e kufirit do të takohej me vijën fillestare të propozuar nga Austria dhe Italia. Ndërsa koloneli Ladhemand dëshironte që kufiri të shkonte në drejtim të perëndimit nga Priasipo Tepesi në Golo, më tutje do të vijonte në përputhje me vijën e propozuar prej delegatit britanik Wylie. Më tej, duke ndryshuar nga propozimi i delegatit të lartpërmendur britanik, vija e tij do të kalonte në veri të Leskovikut dhe do të kryqëzohej me rrugën e Përmetit afër Kakonikolit. Wylie pohonte se ata përsëri ishin dakord që kufiri të kalonte në Tumba por ai mendonte se në këtë rast do të ngrihej më vonë çështja e kompensimit për fshatrat e Poliçanit, Skoriazes dhe Sopikut, dhe nuk kishte mjete për të arritur akordin me Austrinë dhe Italinë. Më përtej, vija e kufirit nga Tumba në drejtim të detit duket se kishte një miratim të përgjithshëm.⁵²

Më 18 nëntor 1913 sugjerimi i kolonelit Doughty-Wylie për vijën kufitare ju paraqit Fuqive. Pas një jave qeveritë austriake e italiane ranë dakord me të por me kushtet e mëposhtme:

1. Çështja vllahe të vendosej drejtpërdrejt midis Greqisë e Rumanisë, por Greqia ta zbraste territorin deri më 31 dhjetor.
2. Vendimi i Fuqive për kufirin dhe evakuimin t'i komunikohet Athinës.
3. Vija e Doughty-Wylie të konsiderohej përfundimtare.⁵³

Qeveria greke shfaqti kundërshtime, duke theksuar se vija e Doughty-Wylie përfshinte në Shqipëri 114.000 grekë nga një popullsi prej 212.000 që kishte rajoni dhe e konsideroi sugjerimin austriak që përkatësia e zonave vllahe duhej diskutuar direkt midis Greqisë e Rumanisë si një përpjekje për të shkaktuar mosmarrëveshje midis dy

⁵² Po aty.

⁵³ FO 881/10492, Ser M. de Bunsen për E. Grey, Vienë 25 nëntor 1913.

kombeve, duke rihapur një çështje e cila ishte zgjidhur në mënyrë të kënaqshme në kohën e nënshkrimit të Traktatit të Bukureshtit.⁵⁴

Edhe serbët u përpoqën që të shfrytëzonin ekzistencën gjoja të një minoriteti serb në krahinën e Dibrës për të modifikuar kufirin në favor të tyre. Por delegati austro-hungarez kundërshtoi pretendimin serb se në këtë krahinë kishte vise që banoreshin prej serbëve dhe shqiptarëve. Ai konstatonte se fshatra të përziera shqiptare e sllave ishin vetëm Globuçishta, Kërçishta dhe Maqellara, por shtonte se sllavët e atjeshëm nuk ishin serbë por bullgarë ekzarkistë, të cilët kishte kohë që protestonin kundër një konfondimi ose bashkimi me serbët. Përfaqësuesi austro-hungarez shtonte se Serbia as që duhej ta hapte gojën për këto fshatra, pasi kështu do të shtrohej çështja e qindra mijë shqiptarëve që kishin rënë nën sundimin e saj. Ai vërente se po të pranohej propozimi serb, do të shkëputeshin nga Shqipëria, jo vetëm 18 fshatra që i përkisnin kazasë së Lumës por do t'i jepej Serbisë edhe territori tjetër me një largësi prej 15 km, pra edhe lugina e Drinit e cila, sipas vendimeve të Londrës, duhej të formonte kufirin.⁵⁵ Edhe delegati britanik kishte afërsisht këtë pikëpamje. Ai i shkruante Grey-t se ishte i prirur që Kazaja e Gorës duhej t'i jepej Shqipërisë për arsye se: *së pari*, shumica e banorëve ose janë shqiptarë, ose, edhe nëse janë sllavë, ata janë më shumë bullgarë sesa serbë; *së dyti*, sepse ata janë kryesisht të fesë myslimane.⁵⁶

Në përfundim, mund të themi se, prezenca e minoriteteve pati vend dhe një farë ndikimi në caktimin e kufijve të Shqipërisë, por gjithsesi Fuqitë më në fund i morën vendimet në përputhje me interesat e tyre politike dhe kompromiseve që ata realizuan në bazë të këtyre kalkulimeve. Fqinjët u përpoqën që t'i shtynin sa më thellë kufijtë e tyre dhe ata jo vetëm që nuk morën parasysh ekzistencën e popullsisë të shumta shqiptare brenda kufijve të tyre por u përpoqën që të trajtonin si minoritete greke apo sllave pjesë të konsiderueshme të popullsisë shqiptare.

⁵⁴ FO 371/1999, Raport Vjetor për vitin 1913 – Greqia, Sër F.Elliot për Sër E. Grey, Athinë 20 maj 1914.

⁵⁵ *HHS.A.P.A.A.*, viti 1914, dos.24-7, dok. 701-800, Kral për kontin Berchtold, Durrës, 15 korrik 1914.

⁵⁶ FO 881/ 10594, Koloneli Granet për Ser Eduard Grey, 13 janar 1914.

*S u m m a r y*THE ISSUE OF MINORITIES IN ESTABLISHING THE SOUTHERN BORDER
OF ALBANIA IN 1913

When the political boundaries of the Albanian state were established, the Great Powers did not consider the minorities as a criterion in delineating them. However, the discussions concerning the minorities are important as they reflect many aspects of the Great Powers' attitudes towards this issue and towards the interested parties i.e. Albania and Greece.

This article, which is largely based on authentic Austro-Hungarian, British and Italian documentary sources, some of which are cited for the first time, deals with several issues. Firstly, the attitude of Great Powers towards the political status of minorities which displays the contradictions and divergences among them. It is clear that, this issue similarly with other problems, was dealt with to suit the political and geo-strategic interests of the Great Powers. They did not consider the will or the rights of these minorities as it was the case with the Vllahs and Albanians. Moreover, they did not try to find a balanced solution which would avoid future divergences and conflicts between the neighboring countries.

Among the Great Powers is noticed the positive and realistic attitude of the Austro-Hungarians and Italians, who supported the will of the Vllah and Albanian minorities and also tried to establish a balance and equality between Albania and Greece in the delineation of the border.

During the delineation of the southern border, the minorities expressed their will as well. It is understandable that the Albanians and Greeks declared that they wanted to be included within the political boundaries of their respective nation states, but what was even more interesting is the case of Vllahs who expressed their will to be included in the Albanian political territory. This attitude was based on their belief that by being included in Albania they would be able to preserve their existence, liberty and their ethnic identity. Initially Rumania held the same position but eventually it was forced to withdraw and to accept some formal guarantees that the Greek government gave in relation to the rights of this minority.

The Government of Vlora backed the will of the Vllah population to include it within the political boundaries of the Albanian state and offered its guarantee to respect their rights and to secure a peaceful and friendly coexistence with the Albanian population. On the other hand, considering the fact that a large Albanian minority was included in the Greek territory, it proposed an exchange of this population with that of the Greeks living in

southern Albania, because it was afraid of the nationalistic policies of ethnic cleansing and assimilation that the Greek government had implemented recently. The demands of the Albanian government were supported by Austro-Hungary and Italy but were strongly opposed by Greece which had the support of the Entente Powers.